

Data 17.02.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti: “Blerje protoksid i azotit për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë” ” *(Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 mujor*

Fondi limit/ Vlera e pritshme është 2,520,000 (dy milion e pesëqind e njetzet mijë) leke pa tvsh.

REF- 38308-02-17-2025

**KODI SIPAS FJALORIT TË PËRBASHKËT TË PROKURIMIT:
-24111000-5**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i perditesuar dhe nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Spitali Rajonal Vlore ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndyshuar dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në të cilën është e përcaktuar se: *"1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla."*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", në të cilën është e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (3 viteve fundit nga data e hapjes së ofertave të tenderit) 2021-2022-2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së

kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit të lotit/loëve që konkuron. Për këtë operatori ekonomik duhet të dorëzojë vërtetim të lëshuar nga Dega e tatimit Taksave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/b dhe pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet:

Neni 43 pika 2/b

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar.

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në *nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", I ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues për gatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.*

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

2.3.1 Dëshmi nga operatori ekonomik për furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë **jo më e vogël se 20% e vlerës së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.**

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Per Prokurimin Publik", në të cilin gjejmë të përcaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", në të cilin është e përcaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim të bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet përvojave të duhura, që janë në përputhje me natyrën e objektit të prokurimit dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe piken 4 të nenit 40 të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën sa **20 %** të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim të bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet

pervojava te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

2.3.2 Operatori ekonomik të deklarojë se disponon në pronësi ose me qera Brenda territorit të Shqipërisë tankera për ruajtjen e gazrave mjekësor me një kapacitet 1/8 e sasise së gazit që kërkohet të prokurohet.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 9 të DST ku te specifikohet pika e mësipërme.

Argumentimi: Ky kriter vendoset ne mbështetje te pikes 2 dhe 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, “Per Prokurimin Publik” dhe behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pasjes se burimeve/kapaciteteve te mjaftueshme per furnizimin me sasine dhe llojin e kerkuar nga AK dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar ne DST.

2.3.3 Operatori ekonomik të provojë se disponon në pronësi ose me qera një mjet transporti për transportin e bombolave të gazit mjekësor protoksid azoti me dokumentacionin përkatës.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 9 të DST ku te specifikohet pika e mësipërme.

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77, pika 1/c të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, ”Për Prokurimin Publik”, me qëllim garantimin e furnizimit me këtë mall për shkak të vetë specifikave të tij dhe rëndësisë që ka për funksionimin normal të institucioneve spitalore si dhe për të provuar kapacitetin teknik të OE me qëllim përmbushjen e kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik të disponojë Vërtetim për regjistrim dhe kontroll nga Inspektoriati i Paisjeve nën presion, për plotësimin e kushteve teknike dhe të sigurisë konform legjislacionit në fuqi që vepron në RSH, jo më parë se tre muaj nga data e hapjes së procedures.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST ku te specifikohet pika e mësipërme.

Argumentim: Ky kriter vihet në përputhje me nenin 40 pika 6/c të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, sipas të cilit mund të kërkohen dëshmi për realizimin e testimeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike dhe eshte ne perputhje me objektin e kontrates. Është patur parasysh se protoksid azoti , mund të tregtohet i ambalazhuar me bombola, të cilat duhet të plotësojnë kushtet e sigurisë konform legjislacionit për enët nën presion.

2.3.5 Operatori ekonomik të vërtetojë se ka rregjistruar pranë ISHTI-it pajisjet nën presion me vërtetim të lëshuar nga struktura përkatëse, Drejtoria e Inspektimit të Pajisjeve nën Presion.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 9 të DST ku të specifikohet pika e mësipërme.

Ky kriter është vendosur në bazë të vendimit nr 40 datë 13.05.2015 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e ISHTI, dhe ligji nr 36/12 datë 24/03/2016 për garantimin dhe funksionimin e pajisjeve nën presion

2.3.6 Operatori ekonomik të paraqesë Deklaratë mbi origjinën e mallit.

Argumentimi: Kjo kërkesë vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion. Ky kriter është në përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", dhe kjo kërkesë i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontratës pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

2.3.7 Për barnat (e listës së DST) të paaautorizuara për tregtim në Republikën e Shqipërisë, bari që ofertohej duhet:

Argumentim: Ky kriter vendoset në zbatim të Nenit 11, pika 2, të Ligjit Nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar, e cila, parashikon:

"2. Në rastet nevojsh të shërbimit shëndetësor (për mjekim ambulator dhe/ose spitalor), për barnat të cilat nuk kanë asnjë alternativë të ngjashme, e cila ka autorizim për tregtim nga Agjencia, ministri përgjegjës për shëndetësinë autorizon importimin e barnave, për të cilat nuk është lëshuar autorizim tregtimi nga Agjencia, sipas rregullave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave".

Gjithashtu, me qëllim garantimin e përmbushjes së standardeve mbi sigurinë, cilësinë dhe efikasitetin e barnave, edhe në rastin e barnave të paaautorizuara, janë aplikuar të njëjtat kërkesa mbi origjinën e tyre, sikurse për barnat e autorizuara për tregtim. Kjo, duke u bazuar në Nenin 12, pika 2, të Ligjit Nr. 105/2014 "Për barnat dhe shërbimin farmaceutik", të ndryshuar, e cila parashikon:

"2. Agjencia i propozon ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhënien e autorizimit të tregtimit për:

a) barnat e prodhuara në vendin tonë;

b) barnat që kanë marrë autorizim për tregtim dhe që qarkullojnë në njërën nga vendet e Bashkimit Europian, Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanada, Turqi, Zvicër, Izrael, Japoni, Australi, Norvegji, Islandë dhe Mbretëri e Bashkuar;

b/1) barnat që kanë marrë autorizim për tregtim lokal dhe që qarkullojnë në vend, duke përmbushur përcaktimet e shkronjës “b” të pikës 2 të këtij neni.”.

c) barnat e prodhuara në vendet e Ballkanit, vetëm kur kanë marrë autorizim për tregtim dhe qarkullojnë në vendin e tyre;

ç) barnat e pajisura me autorizimin e tregtimit nga Agjencia Europiane e Barnave (EMA) ose Institucioni i Administrimit për Ushqimin dhe Barnat (FDA) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës.”

2.3.8 Me qëllim kryesor garantimin e shëndetit publik gjykojmë të arsyeshme që operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë prokurim të paraqesë autodeklarate që disponon leje importi për barin protoksid azoti(N₂O)

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimi i Materialeve: Sipas aneksit 1 të DST

Specifikimi i Materialeve:

-	Permbajtja e N ₂ O jo më pak se	99.5%
-	Permbajtja e NO jo më shumë se	0.0001%
-	Permbajtja e NO ₂ jo më shumë se	0.0001 %
-	Permbajtja e H ₂ O jo më shumë se	0.02 mg/l
-	Permbajtja e NH ₃ jo më shumë se	0.001%
-	Permbajtja e CO ₂ jo më shumë se	0%
-	Permbajtja e CO jo më shumë se	0%
-	Permbajtja e halogjeneve dhe H ₂ S jo më shumë	0 %
-	Permbajtja e PH ₃ e AsH ₃	0 %
-	Permbajtja e acideve dhe bazave	0 %
-	Protoksidi i azotit do të jetë në bombola me kapacitet	27 kg

-Paketimi i Protoksidit të azotit të bëhet me bombolat e shitesit.

-Shitesi ka per detyre te mirembaje, kolaudoje dhe riparoje bombolat me shpenzimet e veta ne perputhje me rregulloren perkatese te miratuar nga Inspektoriati Shteteror i Eneve nen presion.

-Protoksidi i azotit do te jete ne bombola mbi te cilat do te jete e stampuar pesha neto e bomboles.

-Transporti dhe shkarkimi i bombolave te kryhet nga operatori deri brenda ne magazinën e spitalit.

-Cdo furnizim do te shoqerohet me flete analize

Keto kritere jane vendosur nga argumentimi i grupit te punes date 14.02.2025

**Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje apo hapjen e tyre :
Data: 28/02/2025 Ora 10:00**

NJESIA E PROKURIMIT